

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 10

Ngjarje pas datës së periudhës së raportimit

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij Standardi është që të parashikojë:
- (a) kur duhet të korrigjojë pasqyrën e saj financiare një njësi ekonomike për ngjarjet pas datës së periudhës së raportimit; dhe
 - (b) informacionin shpjegues që duhet të japë një njësi ekonomike rreth të dhënave kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare dhe rreth ngjarjeve pas datës së periudhës së raportimit.
- Standardi kërkon që një njësi ekonomike të mos përgatisë pasqyrat e saj financiare mbi një bazë vijimësie nëse ngjarjet pas datës së periudhës së raportimit dëshmojnë se hipoteza e vijimësisë nuk është e përshtatshme.

Objekti

- 2 Ky Standard do të zbatohet për kontabilizimin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të ngjarjeve pas datës së periudhës së raportimit.

Përkufizimet

- 3 Përkufizimet e termave të mëposhtme janë dhënë në këtë standard sipas këtyre kuptimeve specifike:
- Ngjarjet pas datës së periudhës së raportimit* i referohen atyre ngjarjeve të favorshme dhe të pafavorshme që ndodhin ndërmjet fundit të periudhës së raportimit dhe datës kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare. Janë identifikuar dy lloje ngjarjesh:
- (a) ngjarjet që dëshmojnë për kushtet që ekzistojnë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (*korrigjimi i ngjarjeve pas datës së periudhës së raportimit*); dhe
 - (b) ngjarjet që japin të dhëna për kushtet e krijuara pas periudhës së raportimit (*ngjarje të pakorrigjueshme pas periudhës së raportimit*).
- 4 Procesi i përfshirë në autorizimin e publikimit të pasqyrave financiare do të ndryshojë në varësi të strukturës drejtuese, kërkesave statutorë dhe procedurave të ndjekura në përgatitjen dhe përfundimin e pasqyrave financiare.
- 5 Në disa raste, një njësi ekonomike i kërkohet t'i paraqesë pasqyrat e saj financiare aksionarëve për miratim pas publikimit të pasqyrave financiare. Në raste të tilla pasqyrat financiare janë autorizuar për botim në datën e daljes, jo në datën kur aksionarët miratojnë pasqyrat financiare.

Shembulli

Struktura drejtuese e një njësie ekonomike plotëson projekt-pasqyrat financiare për vitin deri më 31 dhjetor 20X1 më 28 shkurt 20X2. Më 18 mars 20X2, Bordi i Drejtorëve rishikon pasqyrat financiare dhe i autorizon ato për botim. Njësia ekonomike deklaron fitimin e saj dhe përzgjedh informacione të tjera financiare më 19 mars 20X2. Pasqyrat financiare i jepen aksionarëve dhe të tjerëve më 1 prill 20X2. Aksionaret miratojnë pasqyrat financiare në takimin e tyre vjetor më 15 maj 20X2 dhe më pas pasqyrat financiare të miratuara depozitohen në një strukturë rregullatore më 17 maj 20X2.

Pasqyrat financiare autorizohen për botim më 18 mars 20X2, (data e autorizimit të Bordit të Drejtorëve për publikim).

- 6 Në disa raste, strukturës drejtuese të një njësie ekonomike, i kërkohet t'ia paraqesë pasqyrat e saj financiare një bordi mbikëqyrës (të përbërë vetëm nga jo-ekzekutivë) për miratim. Në raste të tilla, pasqyrat financiare autorizohen për publikim kur struktura drejtuese autorizon dhënien e tyre për bordin mbikëqyrës.

Shembulli
<p>Më 18 mars 20X2, struktura drejtuese e njësisë ekonomike autorizon pasqyrat financiare për bordin mbikëqyrës. Bordi mbikëqyrës përbëhet vetëm prej personave jo-ekzekutivë dhe mund të përfshijë përfaqësues të punonjësve dhe të interesave të tjera të jashtme. Bordi mbikëqyrës i miraton pasqyrat financiare më 26 mars 20X2. Pasqyrat financiare i jepen aksionarëve dhe të tjerëve më 1 prill 20X2. Aksionarët miratojnë pasqyrat financiare në takimin e tyre vjetor më 15 maj 20X2 dhe më pas pasqyrat financiare i çohen një strukture rregullatore më 17 maj 20X2.</p> <p><i>Pasqyrat financiare autorizohen për botim më 18 mars 20X2, (data e autorizimit të strukturës drejtuese për dërgim në bordin mbikëqyrës).</i></p>

- 7 Ngjarjet pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën kur janë autorizuar pasqyrat financiare, dhe në rast se ato ngjarje ndodhin pas deklarimit publik të fitimit ose të informacioneve të tjera të përzgjedhura financiare.

Njohja dhe matja

Korrigjimi i ngjarjeve pas periudhës së raportimit

- 8 Një njësi ekonomike do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarje të korrigjueshme pas periudhës së raportimit .
- 9 Më poshtë jepen shembuj të ngjarjeve pas periudhës së raportimit që i kërkojnë një njësi ekonomike të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare, ose të njohë zëra që nuk janë njohur më parë:
- (a) Shlyerja pas periudhës së raportimit të një çështje gjyqësore që konfirmon që një njësi ekonomike kishte një detyrim aktual në fund të periudhës së raportimit. Njësia ekonomike korrigjon provizione të njohura më parë të lidhura me këtë çështje gjyqësore në përputhje me SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e kushtëzuara* ose të njohura si një provizion i ri. Njësia ekonomike nuk jep vetëm informacion shpjegues për një detyrim të kushtëzuar pasi shlyerja jep prova shtesë që do të shqyrtohen në përputhje me paragrafin 16 të SNK 37.
 - (b) marrja e informacionit pas periudhës së raportimit që tregon se një aktiv është dëmtuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar ose që shumat e humbjes nga zhvlerësimi i njohur më parë për atë aktiv duhet të korrigjohet. Për shembull: Për shembull:
 - (i) falimentimi i një klienti që ndodh pas periudhës raportuese zakonisht konfirmon se klienti është me kredit të çvlerësuar në fund të periudhës së raportimit;
 - (ii) shitja e inventarëve pas periudhës së raportimit mund të japë të dhëna rreth vlerës së tyre neto të realizueshme në fund të periudhës së raportimit.
 - (c) përcaktimi pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar i kostos së aktiveve të blera ose i të ardhurave nga shitja e aktiveve përpara fundit të periudhës së raportimit .
 - (d) përcaktimi pas periudhës së raportimit i shumës së fitimit nga aksionet ose te pagesave të shumave nëse njësia ekonomike kishte një detyrim aktual ligjor ose një detyrim konstruktiv në fund të periudhës së raportimit për të bërë pagesa të tilla si rezultat i ngjarjeve pas asaj date (shiko SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*).
 - (e) zbulimi i mashtrimeve dhe gabimeve që tregojnë se pasqyrat financiare janë të pasakta.

Ngjarje që nuk korrigjohen pas periudhës së raportimit

- 10 Një njësi ekonomike nuk do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarje të pakorrigjueshme pas periudhës së raportimit .

- 11 Një shembull i ngjarjeve të pakorrigjueshme pas periudhës së raportimit është rënie në vlerën e drejtë të investimeve ndërmjet fundit të periudhës së raportimit dhe datës kur janë autorizuar për nxjerrje pasqyrat financiare. Rënia në vlerën e drejtë normalisht nuk lidhet me kushtet e investimeve në fund të periudhës së raportimit, por reflekton rrethana që kanë dalë më pas. Prandaj, njësia ekonomike nuk duhet të përditësojë vlerat e deklaruar për investimet si në fund të periudhës së raportimit. Në të njëjtën mënyrë, njësia ekonomike nuk i përditëson shumat e dhëna për investime në fund të periudhës së raportimit, megjithëse ajo mund të duhet të japë informacione shpjeguese shtesë sipas paragrafit 21.

Dividendët

- 12 Nëse një njësi ekonomike i deklaron dividendët mbajtësve të instrumenteve të kapitalit neto (siç përcaktohet në SNK 32 *Instrumente financiare: Paraqitja*) pas periudhës së raportimit, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si detyrim në fund të periudhës së raportimit .
- 13 Nëse janë deklaruar dividendët (d.m.th dividendët janë autorizuar ashtu siç duhet dhe nuk janë më në diskrecionin e njësisë ekonomike) pas periudhës së raportimit por para autorizimit për publikim të pasqyrave financiare, dividendët nuk njihen si detyrim në fund të periudhës së raportimit. Dividendë të tillë jepen në shënime, në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.

Vijimësia

- 14 Një njësi ekonomike nuk do t'i përgatisë pasqyrat e saj financiare mbi një bazë vijimësie nëse struktura drejtuese përcakton se pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar ajo ose ka si qëllim të likuiojë njësinë ekonomike ose së ndalojë të tregtuari, ose se ajo nuk ka alternativa të tjera reale.
- 15 Prishja e rezultateve operative dhe pozicioni financiar pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar mund të dëshmojnë nevojën për të shqyrtuar nëse supozimi i vijimësisë është ende i përshtatshëm. Nëse supozimi i vijimësisë nuk është më i përshtatshëm, efekti është kaq bindës saqë këtij standardi i duhen ndryshime bazë në bazën e kontabilitetit, dhe jo një korrigjim i shumave të njohura brenda bazës origjinale të kontabilitetit.
- 16 SNK 1 specifikon informacionin e kërkuar shpjegues nëse:
- (a) Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur mbi një bazë vijimësie; ose
 - (b) Struktura drejtuese është e ndërgjegjshme për pasiguritë materiale të lidhura me ngjarje ose kushte që mund të hedhin një dozë domethënëse dyshimi mbi aftësinë e një njësie ekonomike të vazhdojë në vijimësi. Ngjarjet ose kushtet që kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese mund të ndodhin pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Data e autorizimit për publikim

- 17 Një njësi ekonomike jep informacion rreth datës kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare dhe kush e ka dhënë autorizimin. Nëse pronarët e njësisë ekonomike ose të tjerë kanë fuqinë për të ndryshuar pasqyrat financiare pas publikimit, njësia ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt.
- 18 Është e rëndësishme për përdoruesit të dinë se kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare, pasi pasqyrat financiare nuk reflektojnë ngjarje pas kësaj date.

Përditësimi i informacioneve shpjeguese rreth kushteve në fund të periudhës së raportimit

- 19 Nëse njësia ekonomike merr informacion pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar rreth kushteve që ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit, ajo duhet të përditësojë informacionet shpjeguese që lidhen me ato kushte sipas informacionit të ri.
- 20 Në disa raste, një njësi ekonomike duhet të përditësojë informacionet shpjeguese në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar informacionin e marrë pas periudhës së raportimit, dhe kur informacioni nuk prek shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare. Një shembull i nevojës për të përditësuar informacionin

shpjegues është kur ka prova të disponueshme pas periudhës së raportimit për një detyrim të kushtëzuar që ekzistonte në fund të periudhës së raportimit. Përveç të shqyrtuarit nëse ajo duhet të njohë ose të ndryshojë një provizion sipas SNK 37, një njësi ekonomike përditëson informacionet e saj shpjeguese rreth detyrimit të kushtëzuar duke pasur si bazë këtë provë.

Ngjarje që nuk korrigjohen pas periudhës së raportimit

- 21** Nëse ngjarje që nuk korrigjohen pas periudhës së raportimit janë materiale, mosdhënia e informacioneve shpjeguese mund të ketë ndikim mbi vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të pasqyrave financiare. Si rrjedhim, një njësi ekonomike jep informacionin e mëposhtëm shpjegues për secilën kategori materiale të ngjarjeve të pakorrigjueshme pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar:
- (a) natyra e ngjarjes; dhe
 - (b) një vlerësim të efektit të saj financiar, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.
- 22** Më poshtë jepen shembuj të ngjarjeve të pakorrigjueshme pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar, të cilat në përgjithësi do të rezultojnë në dhënie informacionesh shpjeguese:
- (a) një kombinim i madh biznesi pas periudhës së raportimit (SNRF 3 *Kombinime biznesi* kërkon informacione specifike shpjeguese në raste të tilla) ose disponimin e një filiali kryesor;
 - (b) deklarimin e një plani për të ndërprerë një operacion;
 - (c) blerje të mëdha aktive, klasifikim i aktiveve për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet jo të Vijueshme*, nxjerrje të tjera nga përdorimi i aktiveve ose shpronësim i aktiveve kryesore nga Qeveria;
 - (d) shkatërrimi i një fabrike kryesore prodhimi nga zjarri pas periudhës së raportimit;
 - (e) deklarimi ose fillimi i zbatimit të një ristrukturimi kryesor (shih SNK 37);
 - (f) transaksione kryesore aksionesh të zakonshme dhe transaksione aksionesh të zakonshme potenciale pas periudhës së raportimit (SNK 33 *Fitimet për aksion* i kërkon një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues në formën e një përshkrimi për transaksione të tilla, me përjashtim të rasteve kur transaksionet përfshijnë kapitalizime ose emetime falas (aksione, obligacione), ndarje të aksionit ose ndarje të aksionit rezervë, të cilat të gjitha kërkohet të korrigjohen sipas SNK 33);
 - (g) ndryshime të mëdha anormale pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar në çmimet e aktiveve ose kurset e këmbimit të monedhave të huaja;
 - (h) ndryshime në nivelin e tatimeve ose ligjet e tatimeve, të hyra në fuqi ose të deklaruara pas periudhës së raportimit, të cilat kanë një ndikim material mbi aktivet dhe detyrimet aktuale për tatime ose aktivet dhe detyrimet e shtyra (shih SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*);
 - (i) hyrja në angazhime të konsiderueshme ose detyrime eventuale, për shembull, duke dhënë garanci të konsiderueshme; dhe
 - (j) fillimi i zgjidhjeve të konflikteve të mëdha të dala vetëm nga ngjarjet e ndodhura pas periudhës së raportimit.

Data e hyrjes në fuqi

- 23** Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 23A** SNRF 13, e publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafin 11. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 13.
- 23B** SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, e publikuar në Korrik 2014 ka ndryshuar paragrafin 9. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 9.

Shfuqizimi i SNK 10 (i rishikuar në 1999)

- 24 Ky Standard zëvendëson SNK 10 *Ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar* (i rishikuar në 1999).

